

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6724
E enjte, 6 tetor 2022
çmimi 0.40

Tetë makina reregjistrohen në RKS I FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRIKTA TË SHUMTA PËR QEVERINË KURTI PËR MOSEKZEKUTIMIN
E PAGAVE PËR MËSIMDHËNËSIT

GREVISTËT E ARSIMIT MBESIN PA PAGA, GREVË NUK KA, MËSIMI VAZHDON



Mësimdhënësit në Kosovë kanë mbetur pa paga për muajin shtator, pasi Qeveria, konkretisht Ministria e Financave nuk e ka bërë të mërkurën ekzekutimin e pagave me arsyetimin se një muaj ditë mësimdhënësit kanë mbajtur grevë dhe si rrjedhojë nuk kanë qenë në vendin e punës. Kryetari i Sindikatës së Bashkuar për

Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se tashme kanë një situatë të re dhe për këtë do të marrin sugjerimet nga anëtarësia. Partitë opozitare kanë drejtuar akuza në drejtim të qeverisë Kurti për mosekzekutimin e pagave për mësimdhënësit

AKTUALE



AMBASADORI AMERIKAN VLERËSON
KONTRIBUTIN E KFOR-it
PËR SIGURINË NË KOSOVË F. 5

HAPET TENDERI PËR PJESËN E PARË
TË 'RRUGËS A' NË PRISHTINË F. 6

OSMANI NË PRAGË PËR SAMITIN E
PARË TË KOMUNITETIT POLITIK
EVROPIAN F. 7

EKONOMI



DREJTORESHA E KËSHILLIT TË
BYROVE NGA BRUKSELI:
PO PUNOJMË T'I HAPIM KUFIJTË
PËR QYTETARËT F. 8

KOMISIONI PËR PUNË
MIRATON MARRËVESHJEN
NDËRKOMBËTARE PËR REFORMË
NË SKEMAT SOCIALE F. 8

SPORT



BOBANI VIZITON KOSOVËN: KENI
SHËNUAR PËRPARIM NË AKADEMI DHE
INFRASTRUKTURË F. 10



PROJEKTLIGJI
PËR FALJEN E
GJOBAVE GJATË
PANDEMISË
PROCEDOHEM
PËR NË KUVEND
I FAQE 3



LIBERALIZIMI I VIZAVE, KOMISIONI
EVROPIAN TË ENJTEN PRITET T'UA
SHPËRNDAJË VENDEVE ANËTARE
RAPORTIN PËR KOSOVËN I FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Polonia i kërkon ShBA-së bomba bërthamore



VARSHAVË, 5 MAJ - Presidenti polak Andrzej Duda ka theksuar se Polonia është duke biseduar me Shtetet e Bashkuara për përfshirjen në Programin për shkëmbim bërthamor, që u lejon shteteve aleate të pranojnë armë bërthamore amerikane dhe të jenë në gjendje t'i përdorin ato nëse Amerika ua lejon.

"Problemi i parë është se ne nuk kemi armë bërthamore. Nuk ka asnjë tregues se Polonia mund të ketë armë të tilla në një të ardhme të afërt. Gjithmonë ka mundësi që të marrim pjesë në Programin për shkëmbim

bërthamor. Ne kemi biseduar me liderët amerikanë nëse ShBA-ja po e shqyrton një mundësi të tillë. Kjo çështje është diskutuar", ka deklaruar Duda në një intervistë për gazetën e përjavshme polake "Gazeta Polska".

Presidenti polak tha se kërcënimet ruse për përdorimin e mundshëm të armëve bërthamore tregojnë për mendësinë se "nëse Rusia nuk është e madhe, bota mund të pushojë së ekzistuar".

"Nëse Rusia nis një luftë bërthamore, përgjegjësit për këtë

luftë do të mallkohen në mbarë botën", tha Duda.

Belgjika, Norvegjia, Gjermania, Italia dhe Turqia janë pjesë e programit për përgjigje bërthamore dhe kanë armë bërthamore në bazat e tyre, por ata mund t'i përdorin ato vetëm brenda kornizës së NATO-s për mbrojtje të përbashkët dhe me lejen e ShBA-së.

Në maj gazeta gjermane FAZ shkroi për mundësinë e ndryshimit të konceptit strategjik të NATO-s dhe për të përfshirë në program edhe disa shtete të krahut lindor të Aleancës.

Inflacionit të lartë në Gjermani 'nuk po i shihet fundi'

BERLIN, 5 TETOR - Çmimet në Gjermani do të vazhdojnë të rriten në muajt në vazhdim, kanë treguar rezultatet e një sondazhi të kryer nga Instituti ifo. Sipas të dhënave, të gjitha kompanitë e ushqimit planifikojnë t'i rrisin çmimet në të ardhmen.

Ekonomistët e Muniht, po ashtu, kanë thënë se edhe çmimet e energjisë dhe gazit do të vazhdojnë të rriten. "Fatkeqësisht valës së inflacionit nuk po i shihet fundi ende", ka thënë shefi i Institutit ifo, Timo Wollmershauser.

Të dhënat kanë treguar se 100 për qind e dyqaneve ushqimore dhe 92 për qind e atyre me produkte kimike janë duke planifikuar rritjen e çmimeve.

Çmimet pritet të rriten edhe për lulet, biçikletat dhe pajisjet për zyrë.

Situata është e ngjashme edhe në

industrinë e tekstilit dhe pajisjeve elektronike.

Më 30 shtator Agjencia e Bashkimit Evropian për Statistika - Eurostat ka thënë se inflacioni në Eurozonë ka arritur në 10 për qind në muajin shtator, njëherësh shifra më e lartë prej daljes së euros në treg.

Rritja e kërkesës për produkte dhe shërbime të tjera, pas heqjes së masave kufizuese për luftim të pandemisë së koronavirusit dhe lufta e Rusisë në Ukrainë, besohet se janë dy shkaqet kyçe që kanë ndikuar në rritje të inflacionit në shumë vende të botës.

Disa organizata botërore kanë paralajmëruar se bota mund të përballet me recesion global më 2023. Recesioni përshkruhet si tkurrje e ciklit të biznesit dhe, për pasojë, ka rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik.



Putini nënshkruan ligjin për aneksimin e katër rajoneve ukrainase

MOSKË, 5 TETOR - Presidenti rus Vladimir Putin ka nënshkruar edhe zyrtarisht dokumentet për aneksim të katër rajoneve ukrainase, ka raportuar agjencia ruse e lajmeve TASS. Donjeki, Luhansku, Hersoni dhe Zaporizhja janë rajone që kontrollohen pjesërisht nga forcat ruse prej shpërthimit të luftës së Rusisë në Ukrainë në fund të muajit shkurt.

Ditë më parë dokumentet për aneksim i kanë miratuar të dyja dhomat e parlamentit rus. Putin e ka bërë të ditur vendimin për aneksim pas mbajtjes së të ashtuquajturave referendume në këto katër rajoneve. Perëndimi dhe Kievi i kanë konsideruar këto procese si mashtruese dhe në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar.

Sipas marrëveshjeve të nënshkruara javën e kaluar, në



mes të Putinit dhe zyrtarëve të mbështetur nga Moska në këto katër rajone, periudha e

tranzicionit në territoret e aneksuara ashtu që të jenë tërësisht të inkorporuara në Rusi

do të zgjasë deri më 1 janar të vitit 2026.

Zgjedhjet lokale në këto territore është paraparë të mbahen në shtator të vitit 2023.

Meqë Rusia nuk i kontrollon plotësisht këto rajone, Kremli ende nuk i ka vendosur kufijtë e rinj.

Në dokumentet e nënshkruara nga Putini është thënë se rajonet Donjeck dhe Luhansk do të jenë pjesë e Rusisë si Republika Popullore e Donjeckut dhe Republika Popullore e Luhanskut.

Kufijtë do të përcaktohen sipas situatës së vitit 2014, kur këto dy rajone ukrainase janë marrë me forcë nga separatistët e mbështetur prej Rusisë.

Ukrainasit që jetojnë në territoret e aneksuara do të konsiderohen shtetas rusë, përveç nëse i informojnë

autoritetet lokale se nuk duan diçka të tillë.

Ata kanë një muaj, sipas dokumenteve, që të marrin vendim.

Vendimi i Putinit për aneksim të territoreve është konsideruar shkelje e ligjit ndërkombëtar.

Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se Uashingtoni "nuk do t'i njohë kurrë territoret e Ukrainës si diçka tjetër përveç si Ukrainë".

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.

Vetë Putini e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Projektligji për Faljen e Gjobave gjatë pandemisë procedohet për në Kuvend

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 TETOR - Projektligji që synon faljen e gjobave për shkelësit e masave të vendosura gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 është proceduar në Kuvend pa përkrahjen e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Katër anëtarë kanë votuar kundër këtij projektligji, kurse tre në favor të tij. Shqyrtimi i këtij projektligji në mbledhjen e së mërkurës në Komisionin për Shëndetësi ka përplasur pozitën me opozitën. Derisa partia në pushtet e ka kundërshtuar këtë projektligj, duke e konsideruar diskriminues, opozita e mbështeti atë. Propozuesi i këtij projektligji, Nol Nushi, ka adresuar kritika për Kuvendin e Kosovës për trajtimin me vonesë të kësaj iniciative ligjore. "Projektligji është dorëzuar në qershor të vitit 2021. Sot jemi në tetor të vitit 2022, 15 muaj pas dorëzimit të këtij projektligji në Kuvend po e trajtojmë për herë të parë. Këtë e kam si kritikë për vonesat e paarsyeshme të institucioneve në trajtimin e një projektligji që ka vetëm pesë faqe", ka thënë ai. Nushi ka thënë se falja e gjobave nuk vlen për bizneset e mëdha dhe vetë partitë politike, të cilat, sipas tij, kanë shkelur Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19. Po ashtu, ai ka theksuar se vetëm nga Policia e Kosovës janë shqiptuar 329 mijë gjoba për mosrespektim të masave anti-Covid. "Sot kam marrë nga policia të dhënat që janë në emër të këtij ligji. Janë shqiptuar 329 mijë gjoba. Pra po flasim

gati ¼ e popullsisë në Kosovë është dënuar në emër të këtij ligji dhe në disa matje që janë bërë jemi vendi me më së shumti dënime për kokë banori. Unë kërkoj ndihmën tuaj që ky projektligj të avancohet në procedurat e tyre në mënyrë të shpejtuar dhe të përmirësohet me atë sa keni mundësi, por jo të ndërrohet", ka thënë Nushi. Por kryetarja e këtij Komisioni për Shëndetësi, Fatmire Kollçaku, ka vlerësuar se projektligji i prezantuar ka humbur kuptimin. Madje ajo ka thënë se me faljen e gjobave për ata që kanë shkelur masat anti-Covid bëhet një precedent i rrezikshëm për shëndetin publik. "Ky ligj tani e ka humbur edhe kuptimin e vet. Qytetarët nuk mund t'i ndajmë në të përgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm. Ata që janë përgjigjur kanë qenë të vetëdijshëm që i kanë shkelur edhe ligjet që ishin aktuale në fuqi dhe të gjitha vendimet. Duhet ta mbrojmë shtetin ligjor dhe mos të krijojmë precedentë të rrezikshme kur kemi kriza të tilla kur janë në shëndet publik. Ne mund të themi se ende nuk është mbyllur pandemia, por nuk mund të themi se nuk do të kemi situata të ngjashme", ka thënë ajo.

Mendim të njëjtë me Kollçakun ka shprehur edhe deputeti nga radhët e LV-së, Burim Meta. "Mendoj se janë dënuar të gjithë ata të cilët e kanë shkelur ligjin. Ne sot edhe në komunikacion kemi ndonjëherë tolerime të tilla të ndonjë polici edhe ndaj qytetarëve. Mendoj se nuk duhet të mbështeten ata qytetarë që e kanë shkelur



ligjin", ka thënë ai.

Por mbështetje për projektligjin për faljen e masave ndëshkimore të vendosura gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 kanë ofruar partitë opozitare, PDK-ja dhe AAK-ja. Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, ka thënë se vonesat për procedim të këtij projektligji në Kuvend i ka konsideruar të kundërligjshme.

Haxhiu ka thënë se gjobat kanë qenë selektive dhe janë gjobitur vetëm qytetarët, ndërsa janë amnistuar politikanët. Edhe deputeti nga AAK-ja, Shemsedin Dreshaj, është shprehur pro projektligjit që synon faljen e gjobave të vendosura nga institucionet për mosrespektim të masave anti-Covid.

Projektligji për faljen e masave ndëshkimore të vendosura gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 është iniciativë e qytetarëve të Kosovës si lloj peticioni i cili ishte nënshkruar nga mbi 11 mijë qytetarë. Me Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 ishin paraparë gjoba për të gjithë ata që shkelnin masat anti-Covid.

Shqiptohen 285 gjoba mandatore për ndotësit e mjedisit gjatë muajve mars-gusht

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 TETOR - "Let's Do It - Ta Pastrojmë Kosovën" ka bërë monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Ndëshkime me Gjoba Mandatore si dhe të rregulloreve komunale për mjedis. Gjatë periudhës kohore mars - gusht 2022 janë shqiptuar 285 gjoba mandatore nga inspektorët komunalë në 24 komuna. Më së shumti gjoba janë shqiptuar në komunën e Mitrovicës, gjithsej 60 gjoba. Komuna Podujevë, Istog dhe Mamushë nuk e kanë shqiptuar asnjë gjobë për këtë periudhë kohore, ndërsa komuna e Fushë-Kosovës nuk e ka dërguar numrin e gjobave të shqiptuara. Përveç gjobave mandatore disa nga komunat kanë dërguar fletëparaqitje për gjykatë,

procese verbale dhe kërkesa për gjykatë në kuadër të çështjeve mjedisore.

"Let's Do It-Ta Pastrojmë Kosovën" ka njoftuar se monitorimi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore do të vazhdojë edhe gjatë muajve në vazhdim. "Let's Do It-Ta Pastrojmë Kosovën" ka falënderuar inspektorët komunalë të mjedisit për bashkëpunimin dhe gatishmërinë për ndarjen e të dhënave me qëllim që përmes raportimeve të gjobave mandatore t'i vetëdijesojë ndotësit në mënyrë që të krijohet një mjedis sa më i pastër në gjithë territorin e Kosovës. "Gjithashtu, u bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve që ta rrisin kujdesin për mjedisin, sidomos për pronat publike. Së bashku për një mjedis më të pastër", ka njoftuar "Let's Do It-Ta Pastrojmë Kosovën".





KRITIKA TË SHUMTA PËR QEVERINË KURTI PËR MOSEKZEKUTIMIN E PAGAVE PËR MËSIMDHËNËSIT

Grevistët e arsimit mbesin pa paga, grevë nuk ka, mësimi vazhdon

Mësimdhënësit në Kosovë kanë mbetur pa paga për muajin shtator, pasi Qeveria, konkretisht Ministria e Financave nuk e ka bërë të mundur ekzekutimin e pagave me arsyetimin se një muaj ditë mësimdhënësit kanë mbajtur grevë dhe si rrjedhojë nuk kanë qenë në vendin e punës. Kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se tashme kanë një situatë të re dhe për këtë do të marrin sugjerimet nga anëtarësia. Partitë opozitare kanë drejtuar akuza në drejtim të qeverisë Kurti për mosekzekutimin e pagave për mësimdhënësit

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 TETOR - Ministria e Financave nuk i ka ekzekutuar pagat për muajin shtator për mësimdhënësit grevistë. Kryetari i Sindikatës së Bashkuar

për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se tashme kanë një situatë të re dhe për këtë do të marrin sugjerimet nga anëtarësia. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se sot, si asnjëherë më parë,

mësimdhënësit kanë një qeveri aspak miqësore e empatike me ta dhe një kryeministër të cilit nuk i intereson mirëqenia e as kontributi i tyre historik. "Mësimdhënia është akti më i lartë i optimizmit. Kjo Qeveri, me ose pa vetëdije, po e vret atë, duke rrënjosur pesimizmin e dëshpërimin në zemrat e mësimdhënësve dhe nxënësve. Ftoj qeverinë edhe një herë që, përveç ekzekutimit të pagave të shtatorit për mësimdhënësit, sa më parë të sjellë në Kuvend Ligjin për Pagat, sepse mësuesit tanë meritojnë një trajtim dinjitoz", ka thënë Krasniqi. Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka kërkuar që të paguhet mësimdhënësit. "Asnjë temë tjetër nuk është më e rëndësishme se sa pagesa e

mësimdhënësve. Asnjë video propaganduese, asnjë manipulim me shifra nuk e mbulon temën e pagesës së mësimdhënësve", ka deklaruar Bajrami. Shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se me ndalimin e pagave të shtatorit, Qeveria ka shkelur dinjitetin e mësimdhënësve. "Po ashtu, ndalimi i pagave është cenim i drejtpërdrejtë i mirëqenies dhe ekonomive të familjeve të mijëra mësimdhënësve", ka thënë Tahiri. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë (MASHTI), Arbërie Nagavci, ka thënë se komunat nuk i kanë raportuar Ministrisë së Financave listat e punëtorëve për muajin shtator.

Sipas saj, komunat janë përgjegjëse për organizimin e arsimit parauniversitar dhe janë punëdhënëse të këtyre institucioneve.

Greva në arsim dhe në administratën publike, në nivelin lokal dhe qendror, ka nisur më 25 gusht të këtij viti. Greva është pezulluar pas votimit të anëtarësive të sindikalistëve dhe mësimi ka filluar më 3 tetor.

Sindikalistët kanë mbajtur grevën me kërkesë kyçe për ndarje të 100 eurove për punëtorë, për çdo muaj, deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga.

Qeveria, në anën tjetër, ka publikuar një pako për ndihmë për shkak të rritjes së inflacionit - dhe në të janë ndarë edhe nga 50 euro për të gjithë punëtorët e sektorit publik.

Liberalizimi i vizave, Komisioni Evropian sot pritet t'ua shpërndajë vendeve anëtare raportin për Kosovën

PRISHTINË, 5 TETOR - Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi të mërkurën në Komisionin për Integritet Evropian ka bërë me dije se çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën do të jetë pika e pestë e agjendës në takimin e grupit punues të Këshillit Evropian që do të mbahet më 13 tetor. Bislimi ka theksuar se Kosova ka dërguar në Komisionin Evropian një raport prej 33-faqesh nga i cili komisioni do të përgatisë një rivlerësim të progresit në Kosovë nga 2018 e tani dhe do t'ua shpërndajë vendeve anëtare të BE-së. "Sa i përket liberalizimit të vizave, me sa e di është pika e pestë e agjendës së takimit të ardhshëm të grupit punës që mbahet më 12 dhe 13 tetor. Pika për Kosovën do të jetë në agjendë më 13 tetor. Për ta vendosur në agjendë këtë temë disa nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë kërkuar një

rifreskim, rivlerësim të raportit të Komisionit Evropian për atë se çfarë përparimi ka pasur Kosova nga viti 2018, kur ka qenë vlerësimi i fundit e deri tani", ka thënë zëvendëskryeministri Bislimi. Ai ka thënë se lidhur me këtë staf i tij me departamentet e integriteteve evropiane kanë përgatitur një input prej 33-faqesh të cilin ia kanë dërguar Komisionit Evropian. "Nga ky material Komisioni Evropian ka përgatitur një raport të shkurtër të rivlerësimit që nesër u shpërndahet vendeve anëtare dhe javën tjetër diskutohet në mbledhjen e përbashkët. Hapi i parë është ky, pastaj janë edhe pesë të tjerë. Ne shpresojmë se këto hapa mund të përmbyllen në një periudhë relativisht të shkurtër, por është e padobishme të dalim me datë kur do të ndodhë liberalizimi i vizave", ka thënë Bislimi.



Tetë makina reregjistrohen në RKS



PRISHTINË, 5 TETOR - Nga 1 shtatori deri më 5 tetor tetë makina që kanë pasur targa të lëshuara nga autoritetet serbe janë reregjistruar me targa RKS (Republika e Kosovës). Kështu kanë thënë nga

Ministria e Punëve të Brendshme në një përgjigje dërguar Radios Evropa e Lirë. "Regjistrimet janë bërë në tetë komuna të ndryshme, prandaj nuk mund ta theksojmë ndonjë komunë me

interesim më të madh. Gjithashtu, tani e tutje të gjithë qytetarët mund t'i regjistrojnë automjetet e tyre me targa të rajonit që i përkasin, në të gjitha qendrat e regjistrimit të

automjeteve, pavarësisht vendbanimit të tyre në Republikën e Kosovës", thanë nga MPB-ja. Qytetarët që kanë makina me targa të lëshuara nga autoritetet

serbe, me akronime të qyteteve të Kosovës sikurse KM, PZ, PR e të ngjashme, mund t'i regjistrojnë ato në targa RKS deri në fund të tetorit.

Vlerësohet se rreth 10 000 makina me targa të lëshuara nga Serbia qarkullojnë në komunat në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe.

Qeveria e Kosovës ka thënë se me reregjistrimin në RKS qytetarët serbë do të mund të qarkullojnë me veturat e tyre në mbarë territorin e Kosovës. Por, pas 31 tetorit, autoritetet në Prishtinë kanë paralajmëruar se qytetarët me makina me targa të lëshuara nga Serbia nuk do të mund të qarkullojnë në territorin e Kosovës e as ta kalojnë kufirin.

Procesi i reregjistrimit të makinave fillimisht ishte paraparë të niste në gusht, së bashku me vendimin për lëshimin e një dokumenti për hyrje-dalje për shtetasit e Serbisë që hyjnë në Kosovë. Por, këto dy masa u kundërshtuan nga serbët lokalë të cilët ngritën barrkada në veri të Kosovës më 31 korrik dhe 1 gusht.

Pas ndërmjetësimit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, Kosova dhe Serbia u pajtuan që të hiqnin dorë nga lëshimi për dokumentin për hyrje-dalje, por nuk u arrit ndonjë ujdë për targat.

Ambasadori amerikan vlerëson kontributin e KFOR-it për sigurinë në Kosovë

Prishtinë, 5 tetor - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeff Hovenier, ka pritur në takim lamtumirës komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ferenc Kajari. Hovenieri ka thënë se është

nder për të që ta falënderojë atë për shërbimin e kryer në Kosovë. Ambasadori Hovenier është shprehur se ShBA-ja është e përkushtuar për rolin e rëndësishëm që NATO luan për promovimin e sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë dhe në

rajon. Komandanti i KFOR-it përfundon shërbimin e tij në krye të trupave të NATO-s në Kosovë. Ditët e kaluara ai ka pasur takime të tjera lamtumirëse edhe me zyrtarët e shtetit të Kosovës.



Komuna e Prizrenit dhe DEMOS-i vazhdojnë bashkëpunimin për rritjen e performancës

PRIZREN, 5 TETOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të mërkurën zyrtarët e Projektit për Decentralizim dhe Përkrahje komunave (DEMOS) që zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation - Kosovë (HSI-K), me të cilët bisedoi për evitimin e problemeve në raportin e Zyrës së Auditorit Kombëtar dhe

dokumente të tjera që ndërlidhen me pasqyrat financiare.

Përmes bashkëpunimit të zyrtarëve të projektit DEMOS dhe zyrtarëve të komunës së Prizrenit synohet rritja e performancës, transparencës dhe llogaridhënies komunale, si një prej zotimeve dhe parimeve të qeverisjes aktuale lokale.



Një delegacion i veteranëve të luftës nga Kroacia viziton Kompleksin Memorial 'Adem Jashari'

SKENDERAJT, 5 TETOR - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, bashkë me nënkryetarin Sami Lushtaku, kanë pritur një delegacion të Veteranëve të Luftës nga Kroacia, prirë nga Zoran Komar, i shoqëruar nga "Qytetari i Nderit" i Skenderajt, Esat Çollaku, dhe veteranë të tjerë të luftës në Kroaci dhe Kosovë. Fillimisht ky delegacion është pritur në ambientet e komunës së Skenderajt, për

të vazhduar më pas me homazhe dhe nderime në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, ku janë vizituar edhe shtëpitë muze të familjes Jashari. Kryetari Nura dhe nënkryetari Lushtaku kanë vlerësuar lart rolin e veteranëve të luftës në Kroaci dhe të gjithë shtetit kroat në të gjitha fazat në mbështetje të vlerave tona të lirisë, demokracisë dhe shtetndërtimit.

Hapet tenderi për pjesën e parë të 'Rrugës A' në Prishtinë

Prishtinë, 5 tetor - Komuna e Prishtinës njofton se ka hapur tenderin për pjesën e parë të projektit "Rruga A" e që pritet të kushtojë 9.5 milionë euro. Sipas prokurimit publik, afati për dorëzimin e ofertave është deri më 7 tetor, ndërsa tenderi është me procedurë të hapur, shkruan "Telegrafi".

Në dosjen e tenderit të gjithë operatorët që marrin pjesë për kryerjen e punimeve duhet t'i ofrojnë 50 punëtorë. "Minimum 50 punëtorë, dy referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të

lëshuar nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtes", thuhet në dosje.

Po ashtu, aplikuesit në tender duhet të ofrojnë dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor gjatë tri vjetëve të fundit ka qenë prej jo më pak se 19 milionë euro dhe se kanë përfunduar me sukses kontrata të ngjashme. "Operatori ekonomik duhet t'i ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i operatorit ekonomik gjatë tri viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 19,000,000.00 euro. Lideri i grupit të

operatorëve duhet të përmbushë 60 për qind të kapacitetit ekonomik dhe financiar", thotë njoftimi.

Projekti për ndërtimin e "Rrugës A" do të kryhet në bashkëfinansim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Po ashtu, bashkë me këtë projekt do të ndërtohet edhe kolektori i ujërave të zeza.

Komuna e Prishtinës ditë më parë kishte miratuar buxhetin prej 105 milionë eurosh për vitin 2023 e që mbi 40 milionë euro janë paraparë për projekte të investimeve kapitale.



Komuna e Mitrovicës ka bërë funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të radhës në administratë



MITROVICË, 5 TETOR - Drejtori i Drejtorisë së Administratës në Mitrovicë, Gëzim Stavileci, së bashku me nënkryetarin e komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri, kanë bërë funksionalizimin e sistemit të

menaxhimit të radhës në sektorët e shërbimit të administratës komunale.

Nga drejtori Stavileci është bërë me dije se ky shërbim i avancuar ka për qëllim rritjen e efikasitetit të

shërbimeve ndaj qytetarëve, rritjen e profesionalizimit si dhe ofrimin e shërbimeve sa më të mira e të shpejta për qytetarët e Mitrovicës. Ndërsa nënkryetari Arian Tahiri ka theksuar se jemi të përkushtuar për

të ofruar shërbime sa më cilësore për qytetarët andaj edhe funksionalizimi i sistemit të menaxhimit të radhës do ta mundësojë reduktimin e kohës së pritjes së qytetarëve dhe eliminimin e radhëve në komunën e Mitrovicës.

Fillon ndërtimi i serave për fermerët përfitues në Drenas

DRENAS, 5 TETOR - Komuna e Drenasit, së bashku me Islamic Relief Kosova, kanë nisur realizimin e projektit për ndërtimin e serave për fermerët përfitues të Drenasit. Në kuadër të thirrjes publike,

janë 105 përfitues për ndërtimin e serave dhe sot ka filluar montimi i tyre për fermerët.

Realizimit të këtij projekti i paraprin marrëveshja e bashkëpunimit në mes të

komunës dhe Islamic Reliefit, ku muaj më parë kryetari Ramiz Lladrovci dhe drejtori i Islamic Relief, Mohamet Soliman, kanë nënshkruar këtë memorandum bashkëpunimi.



KDI-ja i publikon problemet e prokurimit në MSh dhe ShSKUK gjatë pandemisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 5 tetor - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar gjetjet nga analiza e procedurave të prokurimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për periudhën pandemike qershor 2020 - shtator 2022.

Në këtë diskutim morën pjesë deputetë nga Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Ministria e Shëndetësisë, përfaqësues nga institucionet që rregullojnë dhe mbikëqyrin shpenzimet publike, përfaqësues afarist, aktorë të shoqërisë civile, medieve dhe komunitetit të donatorëve.

Analiza e KDI-së shpërfaqë probleme sistematike me të cilat është shoqëruar prokurimi publik në sektorin e shëndetësisë në Kosovë gjatë periudhës së pandemisë.

Problemet e evidentuara në këtë drejtim përfshijnë performancën e dobët buxhetore nga Ministria e Shëndetësisë, planifikimet e dobëta dhe joadekuat, vendime që kanë shkaktuar vonesa dhe humbje të parasë publike, aplikimin jostandard të kriterëve të përshtatshmërisë për furnizime, fryrje të çmimeve si dhe kontrolli i dobët në menaxhimin e kontratave.

Po ashtu, analiza potencon dështimin e Ministrisë së Shëndetësisë për përmbushjen e obligimit ligjor për mbulimin e të gjitha shpenzimeve lidhur me trajtimin mjekësor të pacientëve të prekur nga Covid-19.

Diana Metushi-Krasniqi, menaxhere e projektit në KDI, vuri një theks të veçantë në prokurimet e realizuara nga UNOPS-i për Covid-19, përmes një marrëveshje ndërmjet tyre dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Ajo theksoi se qytetarët, përveç që paguajnë shërbimet e UNOPS-it



dhe interesin e huamarrjes, paguajnë edhe çmime deri në 200 për qind më të larta se ato të kontraktuara nga MSh-ja dhe ShSKUK-ja për të njëjtat produkte.

Për më tepër, u potencua që prokurimet e realizuara nga UNOPS-i, me paratë e qytetarëve të Kosovës, nuk janë transparente për publikun. Sa iu përket vaksinave kundër Covid-19, përveç që Kosova ka qenë e fundit në sigurimin e tyre, kontrata dhe çmimi i paguar për to vazhdojnë të mbesin të mbyllura nën kategorizimin si sekret afarist. Metushi Krasniqi vlerësoi që 'sekreti afarist' si klasifikim ligjor rrit rrezikun për korrupsion në shpenzimet publike dhe fshehjen e informacionit për shkak të përshkrimit joadekuat.

Në anën tjetër, deputetët e Kuvendit të Kosovës ngrehën shqetësimet e tyre lidhur me procedurat e prokurimit gjatë pandemisë Covid-19.

Bekim Haxhiu, anëtar i Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, theksoi se janë dy marrëveshje me UNOPS-in të cilat nuk janë miratuar në Kuvend dhe, si të tilla, janë kundërkushtetuese.

Deputeti Haxhiu, po ashtu, theksoi se gjetjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit lidhur me kontratat në vlerë 7-8 milionëshe janë shqetësuese sepse evidentojnë mungesë të raporteve pranimit të mallit, e që rrit dyshimet për abuzime me sasi të pranuar.

Ndërsa anëtari tjetër i Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, deputeti Shemsedin Dreshaj, shtoi se raporti në fjalë, i cili trajton mungesën e transparencës dhe keqpërdorimet potenciale nga MSh-ja, duhet të hetohet nga prokuroria.

Më tutje, sa iu përket shpenzimeve që qytetarët u deshën t'i realizojnë vetë në trajtimin mjekësor për Covid-19,

deputeti Dreshaj shtoi se në protokollet e përpiluara gjatë pandemisë nuk ka pasur listë esenciale të barnave sikurse vendet e tjera. Gjithashtu, ai evidentoi si gabim vendosjen në protokoll të analizës "D-Dimer" e cila nuk mund të bëhej fare në qendrat publike spitalore, andaj pacientët duhej t'u drejtoheshin institucioneve private shëndetësore.

Deputetja Floretë Zejnullahu, anëtare e Komisionit për Shëndetësi, nënvizoi që mosrespektimi i Ligjit anti-Covid nga Ministria e Shëndetësisë është mjaft shqetësues, sidomos duke marrë parasysh barnat dhe trajtimet shëndetësore të cilat është dashur të jenë falas për qytetarët.

Naim Bardiqi, sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, sqaroi se marrëveshja me UNOPS-in është derivat i dy marrëveshjeve me Bankën Botërore, në të cilat

parashihet edhe delegimin e procedurave të prokurimit të UNOPS-i.

Ndër të tjera, ai deklaroi se kushdo mund të ketë qasje në këto marrëveshje, sepse ato nuk janë të klasifikuara. Lidhur me kontratën për furnizim me vaksina kundër Covid-19, ai theksoi se furnizimi me vaksina paraqet sukses, si dhe pavarësisht faktit se kemi qenë të fundit, administrimi i mbi 500 000 dozave të vaksinës brenda 30 ditëve është sukses i kësaj ministrie.

Arianit Jakupaj, kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës, theksoi se, në kohën kur ligji i pandemisë ka qenë në debat publik, kishin kërkuar që t'u kushtohet kujdes i veçantë çmimeve, si dhe që Qeveria dhe Kuvendi të kishin parasysh që Kosovës i duhet një akt nënligjor i cili rregullon tavanet e çmimeve për furnizimet me barna si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Osmani në Pragë për samitin e parë të komunitetit politik evropian

PRISHTINË, 5 TETOR - Me ftesë të presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel dhe kryeministrit të Çekisë, Petr Fiala, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Pragë ku do ta përfaqësojë Kosovën në samitin e parë të Komunitetit Politik Evropian (EPC).

Ky takim inaugurohet do të mbledhë krerë shtetesh nga 44 vende të kontinentit evropian me qëllim të nxitjes së dialogut politik dhe forcimit të bashkëpunimit për t'i adresuar çështjet më urgjente të sigurisë dhe stabilitetit në Evropë.



Krahas pjesëmarrjes në Komunitetin Politik Evropian, sesionet kryesore të presidentja Osmani do të

zhvillojë takime bilaterale me liderë evropianë për të diskutuar për thellimin e bashkëpunimit për tejkalimin e sfidave të përbashkëta.

Para liderëve evropianë presidentja Osmani do ta përçojë mesazhin e përkushtimit të palëkundur të popullit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës për integrimin euroatlantik të Kosovës si garanci për paqe të qëndrueshme në rajon dhe më gjerë.

Gjatë takimeve bilaterale Osmani do të diskutojë edhe për mbështetjen për anë-

tarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Komuniteti Politik Evropian është platformë për koordinim politik e krijuar mbi bazën e propozimit të presidentit francez Emmanuel Macron dhe në të cilën do të bashkohen liderët e 27 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe liderët e 17 vendeve të tjera evropiane.

Kjo nismë synon nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit për çështje me interes të përbashkët, forcimin e sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit në kontinentin evropian.

Komisioni për Punë miraton marrëveshjen ndërkombëtare për reformë në skemat sociale



PRISHTINË, 5 TETOR - Mes kritikave të opozitës është miratuar marrëveshja ndërkombëtare për reformë në skemat sociale në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere. Gjatë raportimit të ministrit të Financave, Hekuran Murati, nënkryetari i këtij komisioni, Mërgim Lushtaku, ka kërkuar reflektim nga qeveria për të tejkaluar, siç ka thënë ai, këtë ngërç edhe në

seancë plenare. “Ne do të abstenojmë për këtë marrëveshje. Kam pritur reflektim për këtë, pasi është hera e tretë që po shqyrtohet pa asnjë ndryshim”, ka thënë Lushtaku.

Edhe dy deputetët nga pozita, Visar Korenica dhe Eman Rrahmani, kanë kërkuar reflektim nga Ministria e Financave, veçanërisht për 15 milionë euro të kësaj kredie.

Para votimit deputeti Korenica ka thënë se pa opozitën nuk kalon kjo marrëveshje në kuvend, prandaj për këtë ai kërkojë të gjendet një formulë për ridestinimin e 15 milionë eurove të kësaj shume që rrjedhin nga kredia 47 milionë euro. “Ne duhet ta gjejmë mbështetjen e opozitës. Kot flasim nga tre-katër orë nëse nuk e kemi mbështetjen e opozitës”, ka thënë Korenica.

Ministri Murati u pajtua me propozimin e bashkëpartiakëve të tij, por deputeti Avdullah Hoti ka thënë se është i vonshëm ridizajnimi i kësaj marrëveshje, pasi që është e nënshkruar tashmë. “Ua ka lënë në dorë këtë marrëveshje Banka Botërore. Ishte dashur atëherë për të kërkuar ridizajnim. Tash është vonë”, ka thënë ai. Ndërsa shqyrtimi i Raportit

Vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 është shtyrë për javën tjetër. Po ashtu, edhe Raporti Vjetor për Fondin e Kursimeve Pensionale për vitin 2021 është shtyrë sërish për javën e ardhshme, ndërsa me shumicë votash Komisioni miratoi Raportin Vjetor Financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2021.

Drejtoresha e Këshillit e Byrove nga Brukseli: Po punojmë t'i hapim kufijtë për qytetarët

PRISHTINË, 5 TETOR - Drejtori ekzekutiv i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku dhe drejtoresha menaxhuese e Këshillit të Byrove nga Brukseli, Greet Flore, kanë mbajtur konferencë për medie në Prishtinë. Pas takimit Mazreku ka falënderuar atë për vizitën duke shtuar se kanë diskutuar për hapat që duhet të plotësohen që të jenë pjesë e Këshillit të Byrove. “Faleminderit që keni ardhur në 11-vjetorin e Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe sot kemi të pranishme Green Floren. Gjatë takimit kemi diskutuar për zhvillimet në tregun e sigurimeve për hapat që kemi ndërmarrë që të jemi pjesë e Këshillit të Byrove. Për këto dy vjet jemi munduar si BKS t'i

kompletojmë të gjitha. Projekti i stickersave ka dhënë rezultate të veta”, ka deklaruar Mazreku. Ndërkaq drejtoresha menaxhuese e Këshillit të Byrove nga Brukseli, Greet Flore, ka thënë se Byroja Kosovare e Sigurimit po bën punë profesionale dhe, sipas saj, së bashku është duke u punuar që të hapen rrugët për qytetarët. “Kemi pasur një byro profesionale dhe është mirë që po i dëgjojmë sërish. Ne jemi duke punuar dhe reflektuar si t'i hapim kufijtë për qytetarë. Pra, që të gjejmë rrugë për ta ndryshuar gjendjen aktuale. Ne i njohim partnerët tanë kosovarë. Ekzistojnë disa pengesa, por nesër do të hyjmë në detaje se si të ecim tutje”, ka theksuar Flore.



AKP-ja shpall rezultatet e shitjes së asetëve përmes likuidimit nr. 59

PRISHTINË, 5 TETOR - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjes së asetëve përmes likuidimit nr. 59 përmes tenderit publik ka

shpallur të mërkurën fituesit e përkohshëm për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje. Për 31 asete sa ishin në shitje, gjithsej u pranuan 36 oferta

dhe vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 969 mijë e 696 euro. Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve, janë

bërë në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të medieve, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm.



Amerika u zbulua 7 herë



Nga Nicholas R. LONGRICH

Kur Kristofor Kolombi zbarkoi në vitin 1492, Amerika ishte në fakt e banuar nga njerëzit prej dhjetëra mijëra vjetësh. Pra ai nuk ishte njeriu i parë që e zbuloi këtë kontinent. Mendohet se njerëzit e kanë zbuluar Amerikën të paktën në 7 kohë të ndryshme. Eksploruesit erdhën nga deti dhe toka, duke sjellë me vete gjene, gjuhë dhe teknologji të reja. Disa qëndruan, eksploran dhe ndërjuan perandori. Të tjerët u kthyen në shtëpi dhe lanë disa shenja si për të treguar se dikur kishin qenë atje. Nga e fundit tek e para, ja cila është historia se si e zbuluam Amerikën:

7. Kristofor Kolombi: Viti 1492 Pas Krishtit

Në vitin 1492, evropianët mund të shkonin në Azi nëpërmjet Rrugës së Mëndafshi, ose duke lundruar në Rrugën e Kepit përreth cepit jugor të Afrikës. Lundrimi në perëndim mendohej të ishte i pamundur. Grekët e lashtë e kishin llogaritur me saktësi se perimetri i Tokës ishte 40.000 km, gjë që e vendoste Azinë shumë larg në Perëndim.

Por Kolombi gaboi në llogaritjet e tij. Perimetri i doli vetëm 30.000 km. Ky gabim, dhe disa supozime të tjera, e nxitën Kolombin të mendonte se distanca nga Evropa në Japoni ishte vetëm 4500 km. Ndërkohë distanca aktuale është gati 20.000 kilometra. Ndaj anijet e Kolombit u nisën pa furnizime të mjaftueshme për të arritur në Azi.

Për fatin e tij ai ndeshin rrugës Amerikën. Por duke menduar se kishte zbuluar Inditë Lindore, ai i quajti njerëzit e saj "Indios", ose Indianë. Ai vdiq pa e kuptuar gabimin e tij. Ishte lundërtari Amerigo Vespuçi ai që e kuptoi se Kolombi kishte zbuluar një tokë të panjohur. Ndaj në vitin 1507 ky kontinent mori emrin e tij.

6. Polinezianët: Viti 1200 Pas Krishtit

Rreth vitit 2500 Para Krishtit, një popull lundërtarësh u nis nga Tajvani për të zbuluar toka të reja. Këta njerëz lundruan në jug përmes Filipineve, në lindje përmes Melanezisë, më pas në Paqësorin e Jugut. Polinezianët ishin mjeshtra në lundrim, duke ditur të lexonin mirë erën, valët dhe yjet për të udhëtuar mijëra kilometra në oqean të hapur.

Duke përdorur kanoe të mëdha, polinezianët nisën të vendosen në ishujt Samoa, Fixhi, Tongan dhe Kuk. Disa prej tyre shkuan në jug, në Zelandën e Re, duke u bërë Maori. Të tjerë shkuan në lindje në Tahiti, Hauai, Ishullin e Pashkëve dhe Markeze. Nga këtu, ata shkuan më në fund në Amerikën e Jugut.

Por më vonë, pasi e kishin eksploruar pjesën më të madhe të Paqësorit, hoqën dorë nga eksplorimi dhe harruan plotësisht Amerikën e Jugut. Por mbetën gjithsesi dëshmitë e atij udhëtimit të jashtëzakonshëm. Amerikanët e Jugut morën pulat nga polinezianët, ndërsa polinezianët mund të kenë marrë patatat e ëmbla të Amerikës së Jugut. Por ata

ndanë më shumë sesa ushqimin. Polinezianët lindorë kanë ADN-në e amerikanëve vendas, pasi u martuan dhe patën fëmijë me ta.

5. Norvegjezët: Viti 1021 Pas Krishtit

Sipas sagave të Vikingëve, rreth vitit 980 Pas Krishtit, Eriku i Kuq, një viking i egër dhe një tregtar shumë dinak, e quajti një shkretëtim të madhe prej akulli "Grenlandë" për t'i joshur njerëzit të zhvendoseshin të banonin atje. Më pas, në vitin 986, një anije e vogël e nisur nga Grenlanda zbuloi brigjet e Kanadasë.

Rreth vitit 1021, djali i Erik, Leif, krijoi një vendbanim në Njufaundlend. Vikingët u përballën në fillim me klimën e ashpër atje, përpara se lufta me amerikanët vendas t'i detyronte ata të ktheheshin në Grenlandë. Këto histori u hodhën poshtë për një kohë të gjatë si mite. Kjo deri në vitin 1960, kur arkeologët gjetën mbetjet e vendbanimeve vikinge në Njufaundlend.

4. Inuit: Viti 900 Pas Krishtit

Populli Inuit udhëtoi nga Siberia në Alaska përmes varkave prej lëkure. Duke u marrë me gjuetinë e balenave dhe fokave, dhe duke jetuar në kasolle dhe Igloo (shtëpi prej akulli), ata ishin përshtatur mirë me Oqeanin e ftohtë Arktik, dhe në një moment i kaluan brigjet e tij deri në Grenlandë. Çuditërisht, ADN-ja e tyre është më afër me atë të banorët vendas

të Alaskës. Kjo nënkupton se paraardhësit e tyre kolonizuan Azinë nga Alaska, dhe më pas u kthyen për të zbuluar sërish Amerikën.

3. Eskimo-Aleut: Vitet 2000-2500 Para Krishtit

Inuitët e kanë origjinën nga një migrim i mëparshëm: ai i folësve të gjuhëve Eskimo-Aleut. Këto janë të dallueshme nga gjuhët e tjera vendase amerikane, dhe madje mund të jenë të lidhura me gjuhët urale si finlandishtja dhe hungarishtja. Provat e ADN-së tregojnë se ajo e Eskimo-Aleut ishte një migrim i veçantë. Ata kaluan nëpër Detin Bering nga Rusia e sotme në Alaskë, ndoshta 4000-4500 vjet më parë, pjesërisht duke u zhvendosur dhe përzier me emigrantët e mëparshëm: popullin Na-Dene.

2. Na-Dene: Vitet 3000-8000 Para Krishtit

Një grup tjetër, Na-Dene, kaloi përmes Detit Bering për në Alaskë rreth 5000 vjet më parë. Edhe pse studime të tjera sugjerojnë se ata u vendosën në Amerikë deri në 10.000 vjet më parë. ADN-ja nga kockat e tyre nuk i lidh ata me njerëzit modernë të grupit Eskimo-Aleut, por me amerikanët vendas që flasin familjen e gjuhëve Na-Dene, si populli Navajo, Dene, Tlingit dhe Apash. Gjuhët Na-Dene, janë më të afërta me gjuhët e folura në Siberi, duke sugjeruar sërish se ato përfaqësojnë një migrim të veçantë.

1. Amerikanët e parë: 16.000-35.000 vjet më parë

Tuajse të gjitha fiset vendase amerikane, Siuks, Komançe, Irokuis, Çeroki, Aztekët, Maat, Keçuat, Janomanit dhe dhjetëra të tjerë, flasin gjuhë të ngjashme. Dher kjo sugjeron se gjuhët e tyre evoluan nga një gjuhë e përbashkët paraardhëse, e folur nga një fis i vetëm që erdhi në Amerikë shumë kohë më parë. Diversiteti i ulët gjenetik i pasardhësve të tyre, sugjeron që ky fis themelart ishte i vogël, ndoshta më pak se 80 njerëz.

Por si arriti në Amerikë? Para se të përfundonte epoka e fundit akullnajore 11.700 vjet më parë, sasi të mëdha uji u bllokuan në akullnaja dhe niveli i detit ra. Fundi i detit Bering u tha, duke krijuar Urën Tokësore të Beringut. Pra njerëzit e parë të Amerikës shkuan në këmbë nga Rusia në Alaskë.

Por koha e migrimit të tyre është ende e diskutueshme. Arkeologët mendonin dikur se populli Klovis, që ka jetuar 13.000 vjet më parë, ishte kolonia e parë të Amerikës. Por tani provat e reja sugjerojnë se njerëzit mbërritën në Amerikë shumë më herët. Kështu disa gjurmë këmbësh të gjetura në Nju Meksiko datojnë 23.000 vjet më parë. Veglat prej guri në një shpellë meksikane mund të datojnë 32.000 vjet më parë. Dhe një mamuth i therur i gjetur i fosilizuar në Kolorado daton midis 31.000-38.000 vjet më parë.

| "The Conversation" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT

QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Bobani viziton Kosovën: Keni shënuar përparim në akademi dhe infrastrukturë

Pak ditë pas vizitës së presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino, Kosovën e ka vizituar edhe një tjetër emër i madh i futbollit botëror. Fjala është për shefin e futbollit në UEFA, Zvonimir Boban, i cili ka thënë se për katër vjet futbollit i Kosovës ka shënuar përparim të madh, sidomos në akademi të futbollit dhe infrastrukturën sportive

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 TETOR - Shefi i futbollit në UEFA, Zvonimir Boban, e ka vizituar të mërkurën Kosovën. Boban është prituri nga kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, dhe bashkërisht e kanë takuar ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrullah Çekun, derisa më pas legjendën e futbollit kroat e ka prituri në takim edhe kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama.

Boban ka bërë homazhe edhe të shtatorja e ish-kryetarit të FFK-së, Fadil Vokrri.

Në konferencë për medie Boban është shprehur i impresionuar me punën që ka bërë FFK-ja me talentë derisa për infrastrukturën sportive ka vlerësuar se është më e mirë se në Kroaci. "Është një nder për mua që të jem këtu në Prishtinë sërish. Kam qenë këtu

para katër vjetësh dhe sot i thashë presidentit Agim (Ademi) se sa shumë kanë ndryshuar gjërat që atëherë dhe jam shumë i lumtur për këtë. Është shumë e lehtë të shikosh këtë diferencë dhe punën që keni bërë me akademinë dhe ekipet e tjera. Jam shumë i impresionuar për punën që kanë bërë autoritetet dhe jam shumë i lumtur për përparimin që keni bërë në këto vite. Duke shikuar infrastrukturën tuaj, mund të them se qëndroni më mirë se Kroacia, pasi ju keni punuar shumë me akademinë", ka thënë Boban. "Është një proces shumë i bukur dhe federata është duke punuar shumë në këtë aspekt dhe që them se qëndroni shumë mirë, duke shikuar nga koha që jeni pjesë e organizatave të futbollit. Ju jeni një vend i ri dhe unë besoj se në një kohë shumë të shkurtër ju mund të arrini shumë më shumë sesa që keni

arritur deri më tani. Të gjithë e dinë për kapacitetet tuaja dhe në të ardhmen mund t'i mposhtni të gjithë. Ka të bëjë me mentalitetin dhe besoj se do të arrini gjëra të mëdha në të ardhmen", ka shtuar Boban. Ndërsa kryetari i FFK-së, Agim Ademi, ka thënë se vizitat e personaliteteve të tilla me ndikim në futbollin evropian e botëror, dëshmojnë respektin që kanë për futbollin e Kosovës. "Mikpritja për të ishte madhështore ashtu siç e meriton legjenda e futbollit kroat dhe evropian, e i cili është shumë i dashur edhe për opinionin në Kosovë. Së bashku e takuam ministrin e sportit Hajrullah Çeku dhe kryetarin e kryeqytetit, Përparim Rama, derisa patëm takim edhe me KE të FFK-së dhe me gjeneratën e artë të futbollistëve, ku diskutuam për futbollin dhe projekte të ndryshme. Po ashtu, vizituam



edhe Kampin Nacional në Hajvali si dhe vendosëm lule të shtatorja e legjendës, Fadil Vokrri, teksa së bashku morëm pjesë në ndeshjen Kosovë - Itali, në kuadër të turneut kualifikues Euro 2023 për Kombëtares U17, që po organizohet nga FFK-ja", ka thënë Ademi, i cili ka shtuar se Boban ka mbetur i mahnitur me pritjen dhe se i ka përgëzuar drejtuesit e

federatës për të gjitha projektet e realizuara dhe ato që janë planifikuar të finalizohen. "Vizitat e personaliteteve të tilla me ndikim në futbollin evropian e botëror, dëshmojnë respektin që FFK ka fituar në instancat e futbollit ndërkombëtar, janë të rëndësishme dhe i sjellin të mira futbollit dhe vendit tonë", ka deklaruar Ademi.

Kosova përfaqësohet me katër garuese në Botërorin e Xhudos

PRISHTINË, 5 TETOR - Ekipi i Kosovës në xhudo do të marrë pjesë në garën më të rëndësishme që prej përfundimit të Lojërave Olimpikë "Tokio 2020". Është Kampionati Botëror i Xhudos, që prej 6 deri më 13 tetor 2022, do të mbahet në Tashkent të Uzbekistanit. Kosova përfaqësohet me katër garuese. Ekipit i prin Distria Krasniqi, që garon në kategorinë deri në 52 kilogramë, Flaka Loxha (-57 kg), Laura Fazliu (-63 kg) dhe Lorian Kuka (-78 kg). Krasniqi është kampione olimpikë Tokio 2020 dhe medaliste e bronzit e botës 2019, Kuka është medaliste e bronzit e botës 2019, ndërsa Fazliu që po shijon formë të mirë këtë vit, është nënkampione e Evropës 2022. Loxha dalëngadalë po



ngrihet në nivele të larta. Të gjithë janë bursistë olimpikë për Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Botërorit do t'i mungojnë familja Gjakova, Nora dhe Akili. Të dy, sipas trajnerit Driton Kuka, mungojnë shkakut i lëndimeve. Nora është kampione olimpikë "Tokio 2020", ndërsa vitin e kaluar fitoi medaljen e bronzit në Botëror në kategorinë -57 kg. Akili

është kampion i Evropës 2021, kategoria -73 kg dhe vendi i shtatë në "Tokio 2020". Xhudistët e Kosovës nisin garat të premtën, kur në tatami është Krasniqi. Loxha garon të shtunën Fazliu të dielën, ndërsa të martën Kuka. Kampionati Botëror është gara që sjell më së shumti pikë olimpikë për "Paris 2024".

Zagklisi vjen në Kosovë

PRISHTINË, 5 TETOR - Sekretari gjeneral i FIBA Botës apo numri një i basketbollit në botë, Andreas Zagklis, do ta vizitojë Kosovën më 6 dhe 7 tetor. Ai do të jetë i pranishëm në finalen e Superkupës Mbarëkombëtare më 6 tetor në Mitrovicë (nga ora 20:00) si dhe do të takohet me krerët e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Të enjten Zagklis do të takohet me krerët e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) nga ora 14:30 në hotelin "Sheraton". Sekretari gjeneral i FIBA Botës, gjithashtu, do të takohet me kryetarin e Prishtinës, Përparim Rama dhe me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës, Hajrullah Çeku. Zagklis është një mbështetës i madh i basketbollit të Kosovës, duke përkrahur projekte



të ndryshme, si dhe FBK-në, ku në shumë raste e ka lavdëruar punën që bën Federata. Kjo është vizita e parë e sekretarit gjeneral të FIBA Botës në Kosovë, duke treguar mbështetjen e madhe për basketbollin e Kosovës.

Kosova të premtën luan kundër Ukrainës

PRISHTINË, 5 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futsall më 7 tetor do ta zhvillojë ndeshjen e dytë në kuadër të fazës "Main Round" në kualifikimet e Botërorit 2024. Pas humbjes me rezultat të

ngushtë si mysafir ndaj Holandës në Rotterdam, "Dardanët" e futsallit, të premtën në Letoni, do të përballen me Ukrainën. "Kemi pasur një grumbullim shumë të mirë. Atmosfera është shumë e

mirë. Djemtë kanë punuar me zell. Do t'i kemi edhe dy stërvitje në Letoni dhe atje do të punojmë ende në aspektin taktik. Ukraina është një prej ekipeve që i kam përcjellë më së shumti, sepse është një prej pesë

top kombëtareve evropiane dhe në çdo kampionat evropian apo botëror arrijnë deri në gjysmëfinale. Por, ne udhëtojmë për t'i befusuar ata. Nëse luftojmë siç kemi luftuar kundër Holandës, mund të arrijmë të



befusojmë", ka thënë përzgjedhësi Arben Simitçiu.

Leclerc dorëzohet: Verstappeni e meriton titullin, duhet të mendojmë për vitin tjetër

MONACO, 5 TETOR - Për herë të parë në karrierën e tyre, Max Verstappen (Red Bull) e Charles Leclerc (Ferrari) dueluan për titullin kampion në Formulën 1. Një titull që do të shkojë te piloti holandez i Red Bullit i cili mund të festojë

që këtë të diel në Japoni, duke u rikonfirmuar kampion bote për pilotë. Ndërkohë që Leclerc pranon dominimin e Red Bullit, duke i "hequr kapelën" rivalit të tij. "Titulli kampion i Maxit është tërësisht i merituar. Më vjen keq vetëm për një gjë.

Kishim një makinë të shpejtë, por këtë sezon humbëm shumë pikë rrugës, duke ia lehtësuar titullin Verstappen", ka thënë Leclerc. "Ky sezon ishte një leksion i mirë për të gjithë ne, pasi kuptuam se çfarë duhet të bëjmë më mirë në të

ardhmen. Ne shpresojmë të fitojmë sa më shumë gara nga ato që kanë mbetur ende pa u zhvilluar, por kjo nuk e zbeh titullin e Maxit. Është koha të mendojmë për sezonin e ardhshëm", ka shtuar piloti i Ferrarit.



Khaka: Frymëzohem nga Kosova

LONDËR, 5 TETOR - Futbollisti me prejardhje nga Kosova, Granit Xhaka, ka dhënë një intervistë për faqen zyrtare të Arsenalit. Ai në këtë intervistë ka përshkruar karrierën e tij futbolistike dhe momentet e vështira që ka hasur deri më tani. Vullneti i jashtëzakonshëm i Granit Xhakës për të fituar, vendosmëria, aftësitë udhëheqëse dhe qëndrueshmëria mund të gjurmohen që nga edukimi i tij në Zvicër dhe, më e rëndësishmja, nga përvojat e prindërve të tij në Kosovë para se të lindte. Granit i ri do t'i kishte këto vërtyte të rrënjësura tek ai nga prindërit e tij kur u rrit në Basel të Zvicrës, dhe ato janë vlera që ende e frymëzojnë atë edhe sot e kësaj dite - si në fushë ashtu edhe jashtë saj. Ai thotë se edukimi i tij i ka dhënë formë mënyrës se si sillet në jetën e përditshme dhe si e jep shpirtin e tij edhe kur luan. "Frymëzimi im kryesor kur fillova karrierën time ishte babai im. Ai luajti futboll vetë para se të lëndohej, por nuk ishte vetëm ajo që më frymëzoi mua - jeta e tij në tërësi. Ai më mësoi të mos heq dorë kurrë nga asgjë, të jem i fortë,



i ashpër mendërisht. Ai ishte djali që më frymëzoi më shumë. Ai ishte lojtar profesionist për një klub në Kosovë kur ishte më i ri, ai ishte anësor por, fatkeqësisht, në kohën kur lindi unë, ai nuk po luante më, sepse duhej të pensionohej për shkak të një lëndimi", ka thënë Xhaka. "Nuk besoj se brezi i ri sot mund ta bëjë këtë. Kur prindërit e mi u larguan nga Kosova para luftës, ata nuk ishin të përgatitur për këtë, por e bën. Nëse ne - kjo gjeneratë do të

duhej të largoheshim nga shtëpitë tona tani - nuk do të ishim të përgatitur, nuk e dimë gjuhën apo ku mund të shkonim. Ju nuk dini kujt t'i besoni. Ju filloni me zero para, minus paratë, kështu që është e vështirë të kuptosh dhe është shumë frymëzuese për mua të vish nga vendi ku kanë ardhur prindërit e mi, sepse nuk mendoj se ne, ky brez i ri, mund ta përballojmë këtë. Është një jetë krejtësisht ndryshe që kemi tani", ka shtuar Xhaka.

Fury: Ata s'e deshën këtë sfidë, ëndrra e britanikëve mbeti peng i Hearnit

LONDËR, 5 TETOR - Bob Arum, promotori legjendar i boksit dhe menaxher i boksierit britanik Tyson Fury, u shpreh se dueli ndaj Anthony Joshuas u sabotua nga Eddie Hearn. Ky i fundit është menaxheri i Joshuas. Sipas Arum, Hearn nuk donte që kjo përballje të zhvillohej dhe përdori çdo mënyrë për ta shtyrë e anuluar atë. "Hearn do të jetë mallkimi i të gjithë britanikëve dhe dashamirësve të këtij sporti, që i vuri shkopin në rrota kësaj sfide. Fury dhe Joshua u shprehën gati të duelojnë më 3 dhjetor, por Hearn doli kundër. Hearn e shkatërroi këtë sfidë edhe kur ne u shprehëm të gatshëm t'i vijojmë negociatat", ka thënë Arum. "Kjo ishte një sfidë ku marrëveshja mund të ishte mbyllur brenda disa orësh dhe ne e pritëm gjithë ditën. E trishtë ajo që ndodhi. Edhe problemi i rrjeteve



televizive të ndryshme të përfshira u zgjidh, por ai gjeti pengesa të tjera. Kam 60 vjet që organizoj duela dhe e di shumë mirë kur dikush nuk e dëshiron një sfidë", ka shtuar Arum. "Hearn e sabotoi këtë sfidë. Ai nuk ka më asnjë boksier të madh në kompaninë e tij përveç

Joshuas dhe po e mban fort. Po e mban peng, pasi ka dy humbje dhe rrezikon të humbasë çdo fitim. Ju e njihni Tyson Fury. Ai nuk ka studiuar drejtësi. Ai dëshiron të duelojë dhe ishte gati për sfidën me Joshuan", ka deklaruar Bob Arum.

SHKURT

Ukraina kandidon për organizimin e Kupës së Botës 2030

Edhe pse Kupa e Botës 2030 është larg, që tani kanë filluar të dalin alternativat e para për vendet organizatore. "The Times" bën të ditur se në garë nuk do të jenë vetëm Portugalia dhe Spanja, por si shtet pritës po mendohet edhe Ukraina. Lufta e fundit dhe sulmet ruse në tokën ukrainase ka bërë që futbollit më shumë se asnjëherë më parë të shpërndajë mesazhe paqeje dhe dashurie mes kombeve. Pikërisht për këtë arsye vendosja e këtij vendi si organizatore e një kompeticioni kaq madhor flet vetë. Çka shton akoma më shumë mundësinë që diçka e tillë të ndodhë është fakti se UEFA ka deklaruar se Kupa e Botës 2030 do të mbahet në Evropë. Në të tilla kushte, bie automatikisht hipoteza e Arabisë Saudite, që ka shprehur prej kohësh dëshirën për të qenë pritëse.

Ten Hag: CR7 nuk është i palumtur, nuk e futa në lojë për shkak të respektit

Erik ten Hag është rikthyer të flasë për Cristiano Ronaldon në konferencën për shtyp para lojës me Omonia Nicosia. Trajneri i Manchester Unitedit insiston se ylli portugez nuk është i palumtur, siç u raportua këto ditë, ndërsa e ritheksoi vendimin e tij për të mos e futur në lojë portugezin në humbjen turpëruese nga Manchester City (3-6), për të mos e ulur dhe nënvlerësuar karrierën e pasur të. "Ndeshja kundër Manchester Cityt ishte mjaft e vështirë. Si gjithmonë, e kemi analizuar, por tash duhet të shikojmë përpara. Cristiano Ronaldo? Nuk e shoh të palumtur. Është duke u ushtruar mirë dhe është i lumtur që është këtu. Kam preferuar të mos e inkuadroj në lojë kundër Manchester Cityt për shkak të respektit, pasi ishim 4-5 gola në disavantazh. Kjo s'ka të bëjë aspak me të ardhmen e tij", ka thënë Ten Hag.

Xavi: Nuk i shfrytëzuar rastet, Interi shënoi nga rasti i vetëm që kishte

Trajneri Xavi Hernandezi insiston se Barcelona pa meritë humbi nga Interi në ndeshjen e vlefshme për xhiron e tretë të fazës së grupeve të Ligës së Kampionëve (0-1). "Ne e dominuam lojën. Nuk krijuam shumë raste, por ata shënuan nga një gjuajtje e vetme. Ata krijuan raste duke gjuajtur vetëm nga jashtë 16-metërshit. Tash i kemi përpara tri finale. I kemi vetëm tri pikë, Interi gjashtë e Bayerni nëntë. Kështu që, jemi në një situatë të vështirë, por do të mundohemi të kualifikohemi", ka thënë Xavi.

Haalandi ka klauzolë për transferim te Real

Sulmuesi Erling Haaland në vitin 2024 mund të transferohet në Real Madrid. Për këtë gjë janë të bindura dhe mediet spanjolle, që raportojnë se sulmuesi norvegjezi ka kontratë në favor të transferimit tek ekipi merengues. "Në kontratën e Haalandit është një klauzolë që i lejon transferimin te Real Madridi në vitin 2024. Një klauzolë që e favorizon shumë ekipin spanjoll", ka thënë ish-futbollisti Malaga Fernando Sanz në programin e njohur "El Chiringuito". Haalandi po zhvillon një sezon të jashtëzakonshëm te skuadra e Manchester Cityt teksa ka shënuar 17 gola në 11 ndeshje në të gjitha kompeticionet.

Inzaghi: Është vetëm fillimi, Barça ishte shumë e fortë

Interi ia doli të fitonte një nga përballjet më të rëndësishme në grupin C teksa mposhti Barcelonën me shifrat 1-0. Trajneri Simone Inzaghi ndihet mjaft i lumtur me fitoren, kurse ka thënë se zikaltrit po e prisnin që një

kohë të gjatë një natë si kjo. "Nuk ishte e papritur, ishte një mundësi e madhe kundër njëri prej skuadrave më të forta në botë. E bëmë lojën që është dashur ta bënim: taktikë, përcaktim dhe vendosmëri. E prisnim që shumë kohë një

natë si kjo, por ende s'kemi bërë asgjë. Jam i kënaqur me lojtarët, klubin, tifozët... Duhet të jetë veç fillimi, por është një natë e rëndësishme që do të mbetet në mendjet tona", u shpreh trajneri i Interit për "Sky Sport". "Unë isha i

dëshpëruar me humbjen nga Roma sepse bëmë lojë të mirë. E net si kjo e sotmja na bëjnë mirë. Ky mund të jetë një rifillim. Barça është e fortë, e kemi studiuar, por kjo skuadër 'live' është edhe më e fortë. Unë s'kam bërë kurrfarë

hakmarrjeje. Ne kemi Interi. Është një moment i vështirë sa iu përket rezultateve, por e pashë një skuadër kompakte, të bashkuar, e cila lufton së bashku. Në të kundërtën, nuk do të mund të fitonim lojë si kjo", ka përfunduar Inzaghi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr. 464/01-53706
Datë: 04.10.2022

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4, nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.20/21 Qershor 2016 Prishtinë, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

VENDIM

I. MIRATOHET shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndikohet nga projekti për ndërtimin e parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan, sipas tabelës të përshkruar nga evidenca kadastrale përkatëse për titullarët e pronës së paluajtshme, pozitën e saj në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqen e saj e cila tabelë paraqet pjesën përbërse të këtij Vendimi.

II. Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 Tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronësor-Juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati i Infrastrukturës.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetat me tirazh më të madh.

I'u dërgohet:
-të gjitha Drejtorive
-Arkivit të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



Page 1 of 2

Përshkrimi detaj i parcelave kadastrale-objekteve sipas Certifikatës-Njesisë kadastrale për shpronësim

K.K. Lipjan Gjendja e vjetër					K.K. Lipjan Gjendja e re		
Nr.	Pronar	Parcela kadastrale-Objektet	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²	Pronar	Kultura-klasa	Sipërfaqe për shpronësim m ²
1.	Shaban Reçica (Osman)	P-71409044-01740-1 ZK Lipjan	Arë e kl.1	433m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	433
2.	Xhevdet Sadiku (Shaip)	O-71409044-01747-0-46-1-1-0 ZK Lipjan	Bodrum	22.05 m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	22.05
3.	Xhevdet Sadiku (Shaip)	O-71409044-01747-0-46-1-4-0 ZK Lipjan	Banesë	52 m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	52
4.	Xhevahire Salihu	O-71409044-01747-0-46-1-5-0 ZK Lipjan	Banesë	39 m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	39
5.	Rahmete Emini	O-71409044-01747-0-46-1-7 ZK Lipjan	Banesë	62 m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	62
6.	Sami Krasniqi (Halim)	O-71409044-01747-0-46-1-2-0 ZK Lipjan	Banesë	42 m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	42
7.	Rufije Sadiku (Rrahman)	O-71409044-01747-0-46-1-1-0 ZK Lipjan	Banesë	52 m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	52
8.	Avdi Jashanica (Kadri)	P-71409044-01743-3 ZK Lipjan Kontratë për shitblerjen e banesës LRP 1217/2013 Nr.i Ref.283/2013- Akt Noterial	Banesë	52m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	52m ²
9.	Burim Limani	P-71409044-01743-3 ZK Lipjan (objekti-Banesë)	Banesë	49m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	49m ²



Page 2 of 2



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PRESDENNIK OPŠTINE

01Br. 464/01-53706
Dana: 04.10.2022

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova, Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4, člana 7 i člana 8, stav 5 zakona Br.03/L-139 Ekspropriaciju nepokretne Imovine, Službene Novine Republike Kosova, Br.52/08 Maj 2009 promene i dopune obavljene sa Zakonom Br.03/1-205, Službene Novine Republike Kosova, Br. / Prishtinë: Nr.91/10 Decembar 2010, stavova člana 83 stavove člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 Službene Novine Republike Kosova, Nr.20/21 Juni 2016 Prishtinë, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipjan 15Nr.110-78095 dt 24.12.2021, Predsednik Opštine Lipjan donosi:

ODLUKA

I. Usvaja se se dalje rasprave zahteva za ekspropriaciju za javni interes nepokretne imovine vlasnika i posedovanja koje se utiče od projekta za izgradnju centralnog gradskog parka i podzemnog parkinga u Lipjanu, prema tabelama opisane iz nadležne katastarske evidencije za titulara nepokretne imovine, njihovo pozicije u okviru projekta javnog interesa kao i njihovo površina tabele koje su deo ove Odluke.

II. Vrednost kompenzacije imovine se određuje od Kancelarije za Procenjivanje Nepokretne Imovine u Okviru Ministarstva Financije Republike Kosova u skladu sa Zakonom Br.03/L-139 za ekspropriaciju nepokretne imovine, sa dopunama i promenama obavljene u Zakonu Br.03/L-205 dt 28 Oktobra 2010 i Administrativnog Upustva Br.02/2015 za usvajanje načina i kriterijumima tehničkih procenjivanja iznosa za nepokretnu imovinu i štete koje se stvaraju u cpropraciju.

III. Za sprovođenje ove Odluke: Kancelarija Predsednika-Pravno Imovinski Sektor, Direktorat za Urbanizam Planiranje i Zaštite Sredine, Direktorat za Geodeziju i Katastar i Direktorat Javne Usluge.

IV. Odluka stupa na snagu dana objavljivanja u Službene Novine Republike Kosova i objavljivanje u nekoj novini sa velikim tiražom.

Dostaviti:
-Svim Direktoratima
-Arhivi Opštine

PRESDENNIK OPŠTINE
Imri Ahmeti



Page 1 of 2

Detaljni opis katastarski parcela prema certifikate-katastarske jedinice za ekspropriaciju

K.K. Lipjan Staro Stanje					K.K. Lipjan Novo Stanje		
Nr.	Vlasnik	Kadastralna Parcela	Kultura-klasa	Površina m ²	Vlasnik	Kadastralna Parcela	Površina Ekspropriacija m ²
1.	Shaban Reçica (Osman)	P-71409044-01740-1 ZK Lipjan	Njiva kl.1	433m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	433
2.	Xhevdet Sadiku (Shaip)	O-71409044-01747-0-46-1-1-0 ZK Lipjan	Bodrum	22.05 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	22.05
3.	Xhevdet Sadiku (Shaip)	O-71409044-01747-0-46-1-4-0 ZK Lipjan	Stan	52 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	52
4.	Xhevahire Salihu	O-71409044-01747-0-46-1-5-0 ZK Lipjan	Stan	39 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	39
5.	Rahmete Emini	O-71409044-01747-0-46-1-7 ZK Lipjan	Stan	62 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	62
6.	Sami Krasniqi (Halim)	O-71409044-01747-0-46-1-2-0 ZK Lipjan	Stan	42 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	42
7.	Rufije Sadiku (Rrahman)	O-71409044-01747-0-46-1-1-0 ZK Lipjan	Stan	52 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	52
8.	Avdi Jashanica (Kadri)	P-71409044-01743-3 ZK Lipjan Ugovor okupoprodaji stana LRP 1217/2013 Br. Ref.283/2013-notarski akt	Stan	52m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	52m ²
9.	Burim Limani	P-71409044-01743-3 ZK Lipjan (objekt-Stan)	Stan	49m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	49m ²



Page 2 of 2



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

NJOFTIM

Në mbështetje të paragrafit 7.3 të nenit 8 të Ligji Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.464/01-53706 datë 04.10.2022, njoftohen të gjithë subjektet të përshkruar në Vendimin e bashkangjitur të këtij njoftimi se:

1. Për arritjen e qëllimit publik për realizimin e projektit për ndërtimin e parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan, mbas plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010, me të cilin miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndikohen nga projekti për ndërtimin e parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullaret e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqet e tyre, e cila tabelë është pjesë përbërse e këtij vendimi.
2. Kryetari i Komunës do të marrë një Vendim Preliminar brenda periudhës prej 30-ditëve kalendarike pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010, lidhur me organizimin e dëgjimeve publike.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin shpronësues, brenda 10 ditëve kalendarike, mbas shpalljes së Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.464/01-53706 datë 04.10.2022, për miratimin e kërkesës për shpronësim ditën e publikimit në njërin nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.
4. Kryetari i Komunës do të mbaj një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e kërkuar për realizimin e projektit për ndërtimin e parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan.
5. Të gjithë personat që janë zyrtar publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronar ose zotërues të interesit në pronë e cila gjindet në këtë pjesë ose avokat apo përfaqësues i ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.
6. Çdo person i interesuar do t'i jepet mundësi e arsyshme për t'i shprehur mendimet e tij/saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2,3,4 të nenit 9 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010.
7. Çdo person i interesuar i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjell me vete prova të arsyshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, Pronari ose Zotërues i Interesit.
8. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave tjera në pronat e paluajtshme që ndodhen brenda juridiksionit territorial të komunës së Lipjanit, do të mbahet me datë 12.10.2022 në ora 10⁰⁰, në objektin Komunës së Lipjanit- sala e Kuvendit.
9. Në rast se prona është objekt i kërkesës shpronësohet pas përmblylljes së procedurës së shpronësimit të inuar në përputhje me at kërkesë asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmisimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përmbushjes së dispozitivave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligji Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 datë 28 tetor 2010. Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtoj Ligjin Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28 Tetor 2010, dhe të kërkojë ndihmë profesionale juridike për kuptimin e drejtave të tyre sipas ligjit.
10. Çdo person i cili nuk është emruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilendo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim menjëherë duhet të dërgojë në Organin shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikura të çfarëdo dokumenti që ndërlidhen në atë pretendim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PRESDENIK OPŠTINE

OBAVEŠTENJE

Na osnovi stava 7.3 člana 8 Zakona Br.03/L-139 za eksproprijaciju nepokretne imovine sa promenama i dopunama obavljene sa Zakonom Br..03/L-205 i Odluke predsednika Opštine 01Br.464/01-53706 dana 04.10.2022 obaveštavamo sve subjekte opisane u Odluci zajedno sa ovom odlukom sa Obaveštenjem:

1. Za postizanje javne namere za realizovanje projekata za izgradnju centralnog gradskog parka i podzemnog parkinga u Lipjanu, nakon ispunjavanja svih uslova u stavu 1 člana 4 Zakona Br.03/L-139 dana.26.03.2009 za Eksproprijaciju Nepokretne Imovine, sa promenama i dopunama u Zakonu Br.03/L-205 dt 28.10.2010, Opština u sprovođenju gorenavedenog zakona usvojila, prema tabeli opisane iz katastralnih evidencijama za vlasnike nepokretne imovine njihovo pozicija u ukviru javne interesakai i njihova površina tabela je deo ovog Odluke.
2. Predsednik Opštine doneće Predhodnu Odluku u roku od 30-kalendarskih dana nakon ispunjavanja uslova određenih sa članom 9 Zakonom Br.03/L-139 dt 26.03.2009 za eksproprijaciju nepokretne imovine , sa dopunom i promenom obavljene u Zakonu Br.03/L-205 dt 28.10.2010,oko organizovanja javnih debata.
3. Svako interesovana stranka ima prava da dostavlja pismena komentere oko predloženog eksproprijaciju od organa eksproprijacije u roku od 10 kalendarskih dana nakon objavljivanja Odluke Predsednika Opštine 01Br.464/01-53706 dana 04.10.2022, za usvajanje zahteva za eksproprijaciju dana objavljivanja u jednom novini sa najvećim tiražom na Kosovo.
4. Predsednik Opštine će održati janu debatu oko tražene eksproprijacije za realizovanje od projekata za izgradnju centralnog gradskog parka i podzemnog parkinga u Lipljanu.
5. Svi zainteresovana lica koji su službenici Opštine,u koju se održava javna debata ili vlasnici,interesovana lica koja se nalazi na ovom delu ili advokat ,predstavnik imaju pravo da učestvuju na javnu raspravu.
6. Svako interesovano lice daće mu se mogućnost da bi dao njegovo mišljenje usmeno oko eksproprijacije u skladu sa stavovima 2,3,4 član 9 të Zakona Br.03/L-139 dt 26.03.2009 za eksproprijaciju nepokretne imopvine, sa dopunama i promenama obavljena sa Zakonom Br.03/L-205 dt 28.10.2010.
7. Svako zainteresovano lice koji želi da učestvuje ili da svoje mišljenje u javnu debatu treba da dostavi sa sobom opravdane (dokumente) koje svedoče da je slušbeno Lice,vlasnik,ili avokat ili Zakonski Predstavnik tog slučbenog lica ,vlasnika ili drugih.
8. Javna rasprava oko predloženog eksproprijacije,prava vlasništva ili drugih prava u nepokretne imovine koje se nalaze unutar teritorialne vlasništvo Opštine Lipljan će se održati **dana 12.10.2022 u 10⁰⁰, Objektu Opštine Lipljan - sala Skupštine.**
9. U slučaju da imovina je objekat zahteva ,se ekspropriiše na osnovu procedure eksproprijacije inicirane u skladu sa tim zahtevom nijedno kompenzacija neće se isplatiti za troškove ili vrednost nekih popravki obavljeno u imovinu,građevinskih objekata ili proširenje objekata u imovinu, ili voča I ostalih biljka nasađenih nakon dana ispunjavanja stavova stava 8 člana 8 Zakona Br.03/L-139 za eksproprijaciju nepokretne imovine sa dopunama i promenama sa Zakonom Br.03/L-205 dt 28 Oktobar 2010. Svako lice koje namerava da ima interes ili neki drugi interes na imovinu savetuje se da razmotri Zakon Br.03/L-139 dt 26.03.2009 za ekspropriisanju nepokretne imovine obavljene u Zakonu Br.03/L-205 dt 28 Oktobar 2010, i da traži pravnu pomoć da bi razumeo svoja Zakonska prava.
10. Svako lice koje nije imenovan sa obaveštenjem i da smatra da ima imovinski interes ili drugi u nekoj parceli nepokretne imovine opisane u Obaveštenju odmah treba da dostavi u Organu ekspropriisanje jedno opisivanje njegove tvrdnje pravno osnovu tog tvrdenja kao i kopije svakakvih dokumentacija koje je vezano sa tim trdenjem.



SH.PANJA REJONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" SH.A. PEJE
Nr. 1444
DATA 05.10.22

Kompania Rajonale për Mbeturina
„AMBIENTI“ – Zyrë Qendrore „ Xhem Sadria „ pn. Pejë
Njësitë Operative: Pejë, Klinë e Istog.

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës dhe në përputhje me Rregulloren e brendshme Nr.015 „mbi mardhënjën në punë të punëtorëve „Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "AMBIENTIT " SH.A. Pejë publikon këtë :

KONKURS

Pozita : Arkatar /e

Vendi i punës Istog (1 pozita)
Kontrat kohë të pa caktuar
Paga sipas akteve të brendshme të ndërmarrjes

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Pranon pagesat në të gatshme dhe plotëson fletëpagesën në tri kopje, kopjen e pare ia dorëzon pales.
- Furnizon –tërheq dhe jep triskat për lëndë djegëse dhe evidencën e tyre.
- Udhëheqë ditarin e arkës veçmas për karburante.
- Të hyrat e gatshme i dorëzon në bankë-xhiro llogarin e Ndërmarrjes, pa vonesë.
- Përpilon ditarin e arkës për çdo ditë mbi të hyrat dhe të dalurat dhe ia
- bashkangjet dokumentacionin në gjendje të rregullt, i verifikuar nga personat e autorizuar.
- Çdo pagesë në favor apo barrë në të gatshme e evidenton në urdhëresat "inkasoni-paguani"
- Është i obliguar që t'i përmbahet maksimumit të mjeteve financiare të arkës për të cilin bjen vendim organi kompetent.
- Çdo ditë i raporton Përgjegjësit financiar të shërbimit për gjendjen në arkë.
- Logarit të ardhurat personale dhe karnetat e të ardhurave i dorëzon në bankë
- Mban përgjegjësi për pagesën e dokumenteve të cilat nuk janë të vërtetuara nga personat e autorizuar, që janë në kundërshtim me ligjin.
- Kryen edhe punë tjera me urdhëresat të Zyrëtarit Kryesor Financiar , Kryeshefit Ekzekutiv
- Për punën e vetë i përgjigjet drejtpërdrejtë Menaxherit të Njësis Operative K.K.Istog
- Nën mbikëqyerjen e Kryeshefit Ekzekutiv „Menaxherit të Njësis Operative K.K.Klinë është përgjegjës për :
- Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin për punësim dhe të njëjtit t'ia bashkangjitin këto dokumenta :
- Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara :
- Shkolla e mesme ekonomike, përparësi Diplome Universitare, Fakulteti Ekonomik „Ekuivalent me Financa
- 1 vite përvojë pune.
- njohja e punës me kompjuter.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
- Dëshmi të përvojës në punë
- Kopja e letërnjoftimit
- Certifikatën që nuk është nënë hetime

Pozita : Punëtor fizikë „në mbledhjen e mbeturinave

Vendi i punës Istog (1 pozita)
Kontrat kohë të pa caktuar
Paga sipas akteve të brendshme të ndërmarrjes

Puntori ka këto detyra dhe përgjegjësi

- 1.Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
- 2.Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e Kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- 3.Pas zbrazjes së Kontenjerve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.

Kualifikimi:

- Shkolla e mesme-
- te ketë përvojë pune.
- Aftësia të mir komunikimi
- Kopja e letërnjoftimit
- Certifikatën që nuk është nënë hetime

Pozitës: Zyrëtar Financiar

Vendi i punës Istog (1 pozita)
Kontrat kohë të pa caktuar
Paga sipas akteve të brendshme të ndërmarrjes .

Për punët dhe detyrat i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv

- Kualifikimet dhe përgatitja profesionale
- Të posedojë diplomë universitare- Fakulteti ekonomik, nga Fusha e Financave/kontabilitetit. (Ekonomist i diplomuar ose master në shkencë ekonomike);
 - Të posedojë përvojë profesionale mbi (3) vite nga fusha e financave dhe kontabilitetit;
 - Të ketë shkathtësi kompjuterike, posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
 - Aftësi për komunikim dhe bashkëpunim me stafin dhe me të tjerët, si dhe aftësi organizative;
- Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:
- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitive financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
 - Organizon udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
 - Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
 - Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
 - Kujdeset për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje –daljet financiare në përgjithësi;
 - Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me Institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
 - Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare;
 - Është përgjegjës për përgatitjen e transferenceve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
 - Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit;
 - Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
 - Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitetet si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
 - Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Kushtet;
- Diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit;
 - Shkathtësi komunikuese dhe aftësi organizative të punës;
 - Njohuri për punë në kompjuter (MS Word, Excel etj.);
 - Njohja e gjuhëve të huaja do të jetë përparësi;
 - Përvoja e punës në menaxhim të biznesit, ose konsulencë së paku 3 vite.
 - Kopja e letërnjoftimit
 - Certifikatën që nuk është nënë hetime

Mënyra e Aplikimit: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" SH.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 27.10.2022 ora 16:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

SQARIM

Gazeta "Epoka e re" ka pranuar një kërkesë nga Gjimnazi "Xhevdet Doda" për publikimin e ftesës për ofertë në faqet e gazetës për datën 1 tetor 2022.

"Epoka e re" ka botuar ftesën për ofertë në datën e caktuar (më 1 tetor) por ka ndodhur një gabim teknik dhe e njëjta shpallje është botuar edhe më 3 tetor (e hënë). Kërkojmë falje për këtë gabim teknik që padashje ka ndodhur.

Shpallja zyrtare është bërë me datën 1 tetor 2022 dhe ajo është valide.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Feride Saramati shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dëshmorët e Vrinë " Vermicë.

- Aida Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Leonita Kajdomqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.

- Erijon Destani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Sinan Thaqi " Zojz.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

